



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 918/14 prot.

Datë 27.06.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 760/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 652/2024, datë 10.06.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të DSHSP MMI”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec, me adresë: Lagjja Nr. 5, Rruga “Islam Dani”, Pogradec.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Trimed” SHPK me NIPT (K51612031J), me adresë: Autostrada “Tiranë – Durrës”, Km.10, Zonë kadastrale 2105, Nr.pasurie 95/11, Kashar, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

*Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

## **I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 10.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 652/2024, datë 10.06.2024, ku vendosi:

[...]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të DSHSP MMI”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 291 prot., datë 18.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 918/11 prot., datë 21.06.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 652/2024, datë 10.06.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të DSHSP MMI”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton**

II.1. Me anë të shkresës nr. 291 prot., datë 18.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 918/11 prot., datë 21.06.2024, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 652/2024, datë 10.06.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “*Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të DSHSP MMI*”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin K.P.P. 652/2024, datë 10.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec, ka zbatuar vendimin K.P.P 652/2024, datë 10.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “*Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të DSHSP MMI*”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.
  2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Anila Malaj

Anëtar  
Gjergj Mersini

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

